



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:119519
Datë: 10.02.2023
Numri i dokumentit: 03964432

A.nr.1450/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Liridona Ajeti Kajtazi, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit F.E., nga Gllogoci, përfaqësuese ligjore e D.H., Gllogoc, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes, me bazë juridike: anulim i vendimit, në shqyrtimin kryesor publik me prezencën e paditëses, me datën 08.02.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. **APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.E., nga Gllogoci, përfaqësuese ligjore e D.H., Gllogoc, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes.

II. **ANULOHET** vendimi i të paditurës i datës 21.02.2022 dhe vendimi i datës 04.05.2022 dhe paditësit i **NJIHET** e drejta në kompensim për përkrahje materiale për përkujdesje për fëmijën me aftësi të kufizuar të përhershme D.H., i lindur më ..., nga data e parashtrimit të kërkesës 13.10.2021 deri më datë 08.02.2023, kurse nga data 09.02.2023 i njihet në vazhdim e drejta për përkrahje materiale për përkujdesje për fëmijën me aftësi të kufizuar të përhershme D.H., në kohëzgjatje prej pesë (5) vite deri më datës 08.02.2028.

III. **DETYROHET** e paditura që paditësit ti kompensoj në mënyrë retroaktive shumën prej 100 (njëqind) euro për muaj, si shumës mujore e përcaktuar për këtë lloj përkrahje materiale për përkujdesje për fëmijën me aftësi të kufizuar të përhershme dhe atë nga data e parashtrimit të kërkesës 13.10.2021 deri më datë 08.02.2023, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë, kurse nga data 09.02.2023 deri më datë 08.02.2028 kompensimi bëhet në baza mujore sipas shumës së përcaktuar për përkrahje materiale për përkujdesje për fëmijën me aftësi të kufizuar të përhershme.

IV. Ky aktgjykim zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter të detyrueshëm.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m i

Paditësja me padi dhe rregullimin e saj ka kërkuar anulimin e vendimit të datës 04.05.2022. Gjatë shqyrtimit gjyqësor mes tjerash ka theksuar se propozojmë ekspertizë mjekësore. Mbetem prapa padisë dhe kërkesës së saj, kërkoj që të anulohet vendimi i shkallës së parë 21.02.2022 dhe vendimi i shkallës së dytë dt.04.05.2022, kërkoj kompensimin prej dt.13.10.2021, sipas shumës për njohjen e të drejtës për përkrahje materiale për përkujdesje për fëmijën me aftësi të kufizuar të përhershëm dhe kjo e drejtë të njihet në vazhdim.

E paditura në përgjigjen në padi, ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke kërkuar të refuzohet kërkesëpadia e paditësit në tersi si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi.

Shqyrtimi gjyqësor i datës 08.02.2023 është mbajtur në mungesë të palës së paditur e ftuar me ftesë të rregullt gjyqësore, në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative ku përcaktohet :

- “1. Mungesa e palës në shqyrtimin verbal nuk e pezullon punën e gjykatës.*
- 2. Për shkak të mungesës së palëve nuk mund të konstatohet se ato kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre, por do të lexohen parashtrësit e tyre.*
- 3. Nëse në shqyrtim nuk vjen as paditësi dhe as pala e paditur, ndërsa shqyrtimi nuk shtyhet, gjykata do të shqyrtojë konfliktin edhe pa praninë e palëve.*

Në kuptim të nenit 368 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, duke pasur parasysh edhe deklarimin e përfaqësuesit të palës paditëse se nuk e ka të nevojshëm prezencën e ekspertëve, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe gjeti se padia e paditësit është e bazuar.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 08.02.2023, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendim i dt.21.02.2022, ankesa e dt.02.03.2022, vendim i dt.23.02.2022, raport Specialistik i dt.02.08.2021, 25.10.2021, 04.04.2022, udhëzim për Konsultim Mjekësor i dt.25.10.2021,25.05.2017,15.01.2018,01.06.2018,22.06.2018,13.04.2018,31.10.2014,05.11.2018,24.05.2017,23.05.2017,06.08.2018,03.02.2018,21.08.2017,16.08.2017,14.08.2017,11.08.2017,11.04.2017,12.04.2017,06.08.2017,07.08.2017,29.07.2017,31.07.2017,17.03.2016,09.07.2018,06.07.2018,29.06.2018,16.07.2018,13.07.2018,01.10.2018,28.09.2018,28.05.2021,01.08.2021, 06.11.2018, 05.04.2017, 04.04.2017, 07.06.2019, raport Mjekësor i dt. 09.02.2022, 01.05.2017,17.07.2017,06.01.2020,22.02.2021,10.06.2019,30.09.2019,03.12.2018, 02.08.2021, 11.09.20217,vendim i dt. 04.05.2022, 06.04.20217,05.01.2020, 25.05.2017, 19.02.2021, 08.06.2017, fatura Nr. PLA353989, dt. 25.10.2021, formulari i Kërkesës për Përkrahje materiale,

Familjeve me Aftësi të Përhershme dt. 13.10.2021, vlerësim i Komisionit Mjekësor, i dt.21.02.2022, shqyrtimi i Ankesave dt.27.04.2020, kërkesë e dt.20.07.2022, fletë lëshim me epikrizë dt.08.03.2016 data e daljes 12.03.2016, akt Përcjellës dt.23.02.2022, pyetësor i dt.18.07.2017, deklaratë dt.19.06.2020, ekstrakt i dt.17.06.2020, ekspertizë mjekësore e dt.22.11.2022.

Me qëllim të vendosjes meritore në këtë çështje juridike kjo gjykate duke u bazuar në neni 43.3 të Ligjit për Konflikte Administrative dhe për të vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje, konform nenit 21 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësim të LPK-së nr.04/L-118, ka caktuar marrjen e provës me ekspertizë mjekësore. Me vendimin e QKU të Kosovës janë caktuar ekspertë mjekësor për dhënien e mendimit profesional. Gjykatës i është dorëzuar ekspertiza mjekësore e datës 22.11.2022 me përbërje të ekspertëve mjekësore të Dr.V.Z., specialiste e kirurgjisë plastike, Dr.-A.B. –kirurgji plastike, Dr. I.F.-defektolog –logoped të cilët kanë dhënë konstatimin *se shkalla e invaliditet është e përhershme sipas gjendjes së fëmijut, që vlerësohet në total me 15 % invaliditet të përhershëm jetësor, si dhe çrregullime grafo-motorike të shkallës së ulët të përhershme që vlerësohet me invaliditet rreth 5 % të përhershëm. Se fëmija ka lindur me anomali kongjenitale të shuplakës së dorës së djathtë-syndactili/gishtërinjtë të ngjitur, gishti i dytë-tretë dhe i katër të cilët gishtërinj janë të operuar ne mes të gishtit të dytë dhe të tretë-katër të cilët gishtërinj tre-katër janë ende të ngjitur dhe jo mirë të zhvilluar gishti i tretë /pra rudimentar.*

Gjykata kishte parasysh Ligjin për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar Nr.03/L-022, përkatësisht nenit 4, të të njëjtit përcaktohet se : *” E drejta në ndihmë materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme realizohet në formë të përkrahjes financiare në para. 4.2 Këto mjete materiale i jepen familjes ose kujdestarit i cili e ofron ndihmën dhe kujdesin për fëmijën me aftësi të kufizuar të përhershëm për të cilin i është njohur kjo e drejtë. 4.3 Lartësia dhe afatet për dhënien e ndihmës materiale përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale”.*

Sipas Ligjit për Përkrahje Materiale Familjeve Të Fëmijëve Me Aftësi Të Kufizuar Nr.03/L-022, përkatësisht nenit 5, të të njëjtit ku përcaktohet se : *“Ndihma dhe kujdesi për plotësimin e aktiviteteve të përditshme jetësore u takon fëmijëve më aftësi të kufizuar të përhershme të moshës 1-18 vjeçare, që janë banor të Kosovës dhe janë me aftësi të kufizuar të përhershme që në mënyrë të pavarur të lëvizin dhe t'i kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore, ku për këta persona është i nevojshëm kujdesi i huaj 24 orësh”.* Kurse neni 6, përcakton se: *“Fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme konsiderohen: a) fëmijët b) fëmijët e verbër si dhe, c) fëmijët të cilët për shkak të natyrës së sëmundjes apo sëmundjeve të përhershme, nuk janë të aftë që në mënyrë të pavarur të lëvizin vetë, në banesë, apo në vendet ku kanë nevojë, as në përdorimin e ndihmesave përkatëse, nuk janë në gjendje të ushqehen vetë, të zhvishen dhe të vishen, të kryejnë nevojat fiziologjike si dhe të mbajnë higjienën e domosdoshme personale”.* Në këtë drejtim Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike, në procedurën gjyqësore ka administruar një mori provash materiale si në arsyetim të këtij aktgjykimi dhe ka konstatuar se nga provat e administruara si raportet mjekësore, e në veçanti nga ekspertiza e QKUK -së, në përbërje nga tre ekspertë, e nxjerrë në procedurë gjyqësore është konstatuar se fëmija ka lindur me anomali kongjenitale, ka

invaliditet të përhershëm jetësor si dhe çrregullime grafo motorike, se shkalla e invaliditet është e përhershme dhe gjykata ia fali besimin kësaj prove dhe provave tjera si raporteve mjekësore të administruara në shqyrtimin kryesor ku dhe ka ardhur në përfundim se fëmija përkrahja material e cila është kërkuar për përkujdesje të të njëjtit është me paaftësi të përhershme- të kufizuar, andaj edhe njihet e drejta në kompensim material për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme në pajtim me Ligjin për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar Nr.03/L-022, përkatësisht nenit 5.

Gjykata konstaton se organi i paditur duke vendosur sipas ankesës së paditësit ka pasur detyrim të nxjerr vendim përmbajtjesor ashtu si parashihet me nenet 47 dhe 48 të LPPA-së, i cili do të duhej ti kishte në përmbajtjen e tij përmbledhjen faktike të çështjes, bazuara në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ, deklarimin e bazës ligjore në të cilat bazohet akti. Arsytimi të jetë i qartë dhe i argumentuar lidhur me mënyrën e vendosjes ashtu si parashihet në dispozitat e lartcekura të LPPA, kur me akt kufizohen, mohohen, shuhen apo preken interesat ligjore ose, vendosen detyrime apo ndëshkime. Nga këto fakte rezulton se i padituri me mënyrën e vendosjes ka nxjerrë vendim jo të drejtë dhe jo ligjor ashtu si parashihet me dispozitat e cekura të LPPA-së.

Gjykata ka vepruar sipas kërkesë së padisë, në kuptim të nenit 2 paragrafi 2.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ku përcaktohet:” *Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse*”, i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe ka aprovuar kërkesën nga data e parashtrimit të saj pranë të paditurës datë 13.10.2021, duke pasur parasysh se paaftësia-invaliditeti i konstatuar te fëmija sipas ekspertizës mjekësore është e lindur andaj në momentin e parashtrimit të kërkesës kjo paaftësi-invaliditet ka ekzistuar, ku Gjykata kishte parasysh po ashtu nenin 26 të Ligjit për Konfliktet Administrative ku përcaktohet:” 2.3. *kthimi i sendeve të marrura dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të kontestuar.*”, dhe po ashtu nenin 46 të këtij Ligji ku përcaktohet:” 5. *Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore*”.

Gjykata kishte parasysh edhe pretendimet e të paditurës por se e njëjta nuk ka argumentuar pretendimet e saj në mënyrë që gjykata të kishte një vendim ndryshe. Në bazë të nenit 63 të LKA-së, dispozitat e LPK-së do të zbatohen përshtatshmërisht në rastet kur LKA nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, andaj bazuar në këtë, gjykata iu referua nenit 7.1 të LPK-së, ku përcaktohet se: “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”, e që e paditura nuk ka argumentuar me prova konkrete pretendimet e saj, si dhe nuk ka mbështetur me prova vendimin e atakuar, e njëjta po ashtu nuk ka shprehur interes të prezantoj në shqyrtim gjyqësor për të argumentuar pretendimet e saj.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lart, gjykata në kuptim të nenit 5,6, 38, 43 dhe 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.1450/2022 me data 08.02.2023

Sekretare Juridike
Nazife Sheholli

Gjyqtarja

Liridona Ajeti Kajtazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit , në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.